



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 105..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 24 / 10 / 2022

VENDIM

Nr.28, date 24 /10/2022

PËR

**ARKIVIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIK PER DIGAT E MEDHA DHE
DAMBAT SI DHE AKTIVITETET E KKDM**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", si dhe legjislacionit përkatës për Arkivat, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 24.10.2022 mori në shqyrtim kërkesën e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA) për rregullat e mbajtjes, sistemimit, arkivimit dhe ruajtjes së dokumentacionit teknik përkatës për digat e mëdha dhe dambat si dhe për pasqyrimin e aktivitetëve të KKDM në zbatim të legjislacionit të fuqi.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve pjesëmarrës, KKDM

VENDOSI:

1. Dokumentacioni teknik për digat dhe dambat duhet të ruhet, sistemohet dhe të arkivohet nga SKDM duke u ndarë në këto kategori
 - Dokumentacioni teknik për digat e mëdha që përdoren kryesisht për prodhim hidroenergjie duke përfshirë pasaportat e digave, planet e emergjencave civile, projektet e zbatimit sipas faktit për ndërtimin e digave të reja dhe rehabilitimin e digave ekzistuese, rregulloret e shfrytëzimit, mirembajtjes dhe monitorimit të digave dhe cdo dokumentacion i nevojshëm sipas legjislacionit.
 - Dokumentacioni teknik për digat e mëdha që përdoren kryesisht për ujë, peshkim, furnizim me ujë duke përfshirë pasaportat e digave planet e emergjencave civile, projektet e zbatimit sipas faktit për ndërtimin e digave të reja dhe rehabilitimin e digave ekzistuese, rregulloret e shfrytëzimit, mirembajtjes dhe monitorimit të digave dhe cdo dokumentacion i nevojshëm sipas legjislacionit.
 - Dokumentacioni teknik për dambat duke përfshirë pasaportat e dambave, planet e emergjencave civile, projektet e zbatimit sipas faktit për ndërtimin e dambave të reja dhe rehabilitimin e dambave ekzistuese, rregulloret e shfrytëzimit, mirembajtjes dhe monitorimit të dambave.
 - Dokumentacioni i aktivitetëve të KKDM duke përfshirë procesverbalet e mbledhjeve mujore, lajmet në sektorin e digave, faqen e internetit të KKDM, takimeve me komitetet homologe, marrëveshjet e bashkëpunimit, raportet vjetore dhe cdo dokumentacion i kërkuar në bazë të legjislacionit në fuqi,
 - Dokumentacioni i bibliotekës së KKDM duke përfshirë literaturën teknike, buletinet e ICOLD, libra dhe revista të ndryshme të vlefshme për aktivitetet në fushën e digave si dhe promovimin e tyre.
2. Të caktoj z. Gent Ahamataj, shef sektori i SKDM, përgjegjës për arkivimin e dokumentacionit teknik të mësipërm sipas legjislacionit në fuqi, organizimin e mbledhjeve të KKDM, përgatitjen e informacionit të duhur në lidhje me plotësimin e kërkesave të ligjit dhe të VKM në lidhje me dokumentacionin teknik të projekteve dhe studimeve që duhet të shqyrtohen në mbledhje. Shefi i sektorit të SKDM duhet të marrë pjesë në cdo mbledhje të KKDM dhe është përgjegjës për njoftimet e antarëve të KKDM si dhe pasqyrimin e aktivitetëve në faqen e Internetit www.albcold.gov.al.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

3. Të caktoj zj. Rolanda Hila, si antare të KKDM dhe përfaqësuese e SKDM, përgjegjëse për korrespondencën e KKDM me shfrytëzuesit e digave, përgatitjen e dokumentacionit të mbledhjeve dhe informimin e Antarëve me çështjet që do të trajtohen në mbledhje, mbajtjen e procesverbaleve dhe përgatitjen e Vendimeve të KKDM;
4. Ti kërkojë SKDM që brenda muajit Janar të cdo viti të përgatit një Raport vjetor të detajuar për vitin parardhës në lidhje me gjëndjen e dokumentacionit të mësipërm, problematikën, mungesat si dhe masat për të ardhmen.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

